


DI
DRITA ISLAME

RIKTHIMI TE LIRIA PËR TË *Besuar*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

URTËSI

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al


Viti XXIX i botimit
Nr. 11 (454)
Nëntor, 2020

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.



PËRMBAJTJA


- 4 30 vjet liri besimi / Dorian Demetja
- 6 Rikthimi te liria për të besuar/ H. Bujar Spahiu
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Përsiatje e shkurtër mbi lindjen e njeriut modern / Nuredin Nazarko
- 14 30 vjet nga rikthimi i fesë në Shqipëri / Hadi H. Lluja
- 16 Mënyra e mbajtjes së duarve në namaz / Shkëputur nga libri "Argumente bazë të Fikhut Hanefi", të autorit Abdurrahman bin Jusuf Mangera, botim i KMSH-së.
- 20 Faleminderit Ademit, a.s., nga rëfimi i tij kam mësuar... / Përktheu dhe përshtati: Pim.dr.med.sc. Al F. Ijazi
- 22 Jetën time ta dedikoj ty ja Resulallah / Qani Sulku
- 24 Një koleksion për veprat islame në Danimarkë / Genti Kruja



- 26 Vetmia dhe uniteti / Përshtati: Arbi Tarja
- 30 Haxhi Hafiz Sabri Koçi / Xhemal Balla
- 34 Këshilla të mrekullueshme
- 35 Poezi e shkruar nga Hafiz Abdullah Zëmbaku (1892-1960)
- 36 Koncepti i familjes në islam / Xhoxhina Seferi
- 38 Nuk është nga ne ai që mashtron!
- 38 Kush është i pasur e kush fukara?!





30 vjet liri besimi

Pas 23 viteve të ndalimit të fesë me ligj, Zoti bëri të mundur që me datë 16 nëntor 1990, të rihapet xhamia e parë në Shqipëri, ajo e Plumbit në Shkodër. Hapja e xhamisë së Plumbit ishte shkëndija e parë, që dha sinjalin fatlum se Islami jo vetëm që nuk ish harruar, por vazhonte të ishte i gjallë e i freskët në zemrat e shqiptarëve. Ky veprim historik për Shqipërinë, vërtetoi edhe një herë ajetin e Kur'anit Famëlartë: "Thuaj: "E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket"! (Isra, 81)

Në këtë ditë të shënuar, ne kujtojmë me respekt dhe nderim ata bijë e bija shqiptare, të cilët morën iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë dhe për të rifituar të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar. Rreziku ishte shumë i madh, por zemrat e besimtarëve nuk mund të rezistonin më ndalimin e praktikimit të fesë. Pjesëmarrësit në këtë ngjarje tregojnë se ajo ka qenë një ditë sa e gëzueshme dhe mallëngjyese, po aq e guximshme dhe e rrezikshme për të ardhmen e besimtarëve. Sipas Faik Hoxhës, ish Myftiut të Shkodrës, iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë, për të falur namazin e ditës së xhuma, në thelb për të ripërtërirë fenë, për të rifitur të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar, e mori

rinia e Shkodrës. Ndërsa pjesa që spikaste më tepër në këtë iniciativë, ishte se në rihapjen e objekteve të kultit, ndihmuan edhe përfaqësues të besimit katolik e ortodoks të qytetit të Shkodrës. Kjo panoramë pasqyroi qartë frymën e bashkëpunimit dhe respektit për besimin dhe vlerat e njëri-tjetrit.

Në këtë ditë të shënuar, ne kujtojmë me respekt Haxhi Hafiz Sabri Koçin, pishtarin e ringjalljes së Islamit në Shqipëri, i cili në praninë e afro 55 mijë vetave do të shprehej: "Gëzimi më i madh imi ka qenë më 16 nëntor... sikur linda përsëri... E pashë veten aq të lumtur, sa që nuk kisha gajle edhe sikur të bija kurban. Nuk kishte gëzim më të madh!" Do të ishte hoxha i njohur e i nderuar, 69-vjeçari Haxhi Hafiz Sabri Koçi, i burgosur për shumë vjet nga regjimi komunist, ai që do këndonte ezanin dhe do falte xhumanë pas 23 vitesh heshtje. Në fjalën e hapjes, hirësia e tij Haxhi Hafiz Sabri Koçi, më pas kryetar i parë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë pas komunizmit, vuri në dukje nevojën e ushtrimit të fesë nga çdo njeri dhe në çdo kohë. Ai pasi falënderoi Zotin për mirësitë e Tij të panumërta, vlerësoi lart mundin dhe përpjekjet e të gjithë atyre që ndihmuan në rikthimin e xhamisë në gjendjen e saj funksionale. Nga xhamia e Plumbit u dëgjuan pas shumë vitesh ajetet e

Kur'anit dhe Hadithet e Muhamedit (a.s.), të cilat me besnikërinë më të madhe i kishte ruajtur në kujtesën e tij Hafiz Sabriu. Përmbajtja e tyre mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi e vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Ngjarja e 16 nëntorit nuk ishte thjesht një ceremoni fetare. Ajo krahas vlerës së vet të ringjalljes së fesë, ishte një dritë shprese për të ardhmen e Islamit në Shqipëri. Po atë ditë u vendos rithemelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili me ndihmën e Zotit, me shumë mund dhe sakrificë, arriti të ngrihet së bashku me myftinitë, medresetë dhe Universitetin Bedër, një institucion që i shërben mbarë popullit shqiptar në të gjitha aspektet. Duke përkujtuar këtë ngjarje, këtë ndodhi të madhe pas 3 viteve (1993), Ismail Muçej, ish kryeredaktor i gazetës "Drita islame", shprehet: "Deshi s'deshi qeveria e asaj kohe, feja u legalizua praktikisht, duke dhënë shkëndijën e parë për qytetet dhe fshatrat e tjera të Shqipërisë, të cilat filluan të hapin njëra pas tjetrës falore."

Vlerësim dhe mirënjohje për të gjithë ata njerëz, që me përkushtim kontribuan me shpirtin dhe pasurinë e tyre në skalitjen e datës 16 Nëntor 1990 në kujtesën historike të kombit tonë, si dita e lirisë së besimit.

RIKTHIMI TE LIRIA PËR TË Besuar

Më 16 nëntor 1990, në Xhaminë e Plumbit, Shkodër, H.H.Sabri Koçi mbajti hutben e parë pas 23 vitesh. Hafizi vuajti në lëkurën e tij persekutimin komunist, për 20 vjet e 4 muaj burgim.

Ne u bëmë vendi i parë dhe i vetëm në botë që sanksionuam me kushtetutë ateizmin.

Kleri u persekutua, hoxhallarë e priftërinj u martirizuan.

U edukua e gjithë shoqëria me frymën anti-fetare.

Komunizmi ateist tentoi të prishë ADN-në e shqiptarit, edukoi një brez të tërë pa ndërgjegje, me ideale vetëm materialiste, bëri shpirtin e njeriut akull, denaturoi esencën e njeriut, humanizmin.

Eksperimenti unik në botë për të krijuar "njeriun e ri" zgjati 23 vite.

-16 nëntor 1990, dita më e bukur e jetës sime, thoshte Hafiz Sabriu.

Ndoshta, për të lindurit pas viteve 1990-të, kjo thënie e Hafizit mund të duket paksa e çuditshme!

I nisa këto radhë për të folur për lirinë, lirinë e besimit, dhe siç e do zakoni, në kësi rastesh duhet t'i referohesh së tashmes përgjithësisht. Padiskutim ashtu është, por është shumë e rëndësishme të mos harrojmë të shkuarën! Të mos i njohim tragjeditë e së shkuarës thjesht si çështje teatrale, si ngjarje që kanë ndodhur dikur dhe nuk përsëriten. Rendet autoritare, sidomos komunizmi, nuk e durojnë dot besimin në Zot, dorëzimin e njeriut të Zoti i Gjithësisë si e vetmja fuqi absolute.

Gjithësesi, edhe pse 23 vjet ngricë shpirtërore, shumë shqiptarë kishin mbrujtur brenda tyre dashurinë për Zotin, ruajtën ndezur brenda shpirtit të tyre një zjarr që nuk lejoi ngricën komuniste të ftohte besimin e tyre në Zot. Kjo gjë u vërtetua në muajin nëntor 1990,

xhumaja e parë dhe mesha e katolikëve, mbajtur në qytetin e Shkodrës.

Në atë falje të xhumasë, së 16 nëntorit, morën pjesë mbi 55 mijë vetë. Ky ishte një tregues se besimi në Zot nuk shuhet dot me ligj, edhe pse shkaktoi dëme të jashtëzakonshme, sërish etja e shpirtit për Zotin e tij ishte shtuar.

Në këtë 30 vjetor liri besimi në Shqipëri, mund të themi pa asnjë dyshim se, fetë, të gjitha komunitetet fetare, kaluan më shpejt dhe më me sukses atë periudhën kohore të quajtur tranzicion, sesa çdo aspekt tjetër social. U ringritën objektet e kultit, u rihapën dhe konsoliduan institucionet arsimore me frymë fetare.

Tradita e tolerancës fetare vazhdoi aty ku e kishim lënë, mirëkuptimi dhe vëllazëria nuk janë vënë në diskutim asnjëherë. Edhe me çytje, të brendshme apo të jashtme qofshin, gjëra krejt normale në një sistem të hapur, nuk kanë mundur dot të lëkundin kollonat e vëllazërisë e tolerancës.

Komunitetet fetare, ai mysliman që unë kam privilegjin të përfaqësoj, dhe komunitetet e tjera që drejtohen nga vëllazërit e mi të nderuar, kanë qenë kontribuese për



paqen sociale në ditë të mira dhe në ditë të vështira. Gjendja shpirtërore, e këtyre viteve që po jetojmë, është e volitshme për kapërcime edhe të disa hijeve jo fort të këndshme në shoqërinë tonë.

Etosi harmonik i shoqërisë tonë nuk është rastësi.

Nuk është arritur thjesht nëpërmjet institucionalizimit të programuar, më respekto, të të respektoj, ndryshe shkojmë para ligjit!

Ka patur momente në historinë e kombit tonë ku ligji nuk ka pasur shumë fuqi, por kjo gjë kurrë nuk ka çuar në një konflikt midis dy shqiptarëve për shkak të besimit.

Ky aspekt është një nga pasuritë më të mëdha që kemi kultivuar e mirëmbajtur këto 30 vite si shoqëri, aq sa shpesh herë na e përdorin si "mall" për eksport.

Në këtë 30 vjetor, është rasti të sjell në kujtesë se pasojat e "njeriut të ri" nuk janë venitur ende. Ka minoranca të kamufluara nën petkun e laicizmit dhe lirisë që keqpërdorin pikërisht këto dy koncepte.

Nuk mund të rrimë pa sjellë në vëmendje se ekziston një diskriminim i pakuptimtë, në disa aspekte, ndaj gruas myslimane në Shqipëri.

Mbulesa fetare!

Përdoret shpesh një gjuhë pezhorative ndaj këtij obligimi fetar dhe zgjedhje të lirë për gruan myslimane.

Një tjetër aspekt, shenjtëria e Profetit Muhamed (a.s.), hera-herës, nuk respektohet gjithashtu. Profeti ynë i dashur, ashtu sikurse të gjithë profetët të cilët ne

i pranojmë, kanë bashkëjetuar me ateistë, me laikë, me besimtarë të besimeve të ndryshme nga besimi që vetë ata predikonin. Por, profetët nuk kanë fyer kurrë kënd, edhe pse janë fyer në mënyrat më të ulëta. Edhe ne si ndjekës të tyre këtë gjë përpiqemi të bëjmë. Të qenët të paqtë, është burim frymëzimi profetik për ne.

Pluralizmi në Shqipëri është i ri, fenomene të tilla janë guralecë që ngadalësojnë këtë mekanizëm gjigant të ecë me shpejtësinë e duhur përpara.

Shumë është arritur këto 30 vite, por sigurisht edhe shumë mbetet për t'u bërë, në kesi çështjesh, për t'u tejkaluar.

Ne kemi barrën për të kuruar sa mundemi pasojat që ka lënë te një brez i tërë doktrina e "njeriut të ri", kemi gjithashtu përgjegjësinë për të qenë edukatorë të mirë dhe shembull i mirë për brezin e ri që po rritet.

Duhet që gjithësekush nga ne ta shohë këtë si përgjegjësi të vetja e tij, të mbrujtim vlerat më të pastra fetare, patriotike dhe edukative të rinia jonë!

Të ushqejmë vazhdimisht ndjenjat e respektit për njëri-tjetrin, pavarësisht besimit apo bindjeve të gjithsecilit!

Data, muaj, apo vite që shënojnë ngjarje të rëndësishme në histori, duhet të na shërbejnë si momente reflektimi për çdo njërin nga ne.

Kështu, ne do të mund të jemi vlerësues ndaj vlerave të tilla si liria, toleranca dhe harmonia midis njëri-tjetrit.

1

VIZITË PUNE NË MYFTININË E GJIROKASTRËS

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi ditën e premte më datë 17. 10. 2020, një vizitë pune në Myftininë e Gjirokastrës, nga ku edhe mbajti hutben e xhumasë në Xhaminë e Pazarit.

Temë e hutbes së Kryetarit ishte "Besnikëria".

Ai solli shembullin më të bukur dhe më kuptimplotë të besnikërisë, shembullin e Profetit Muhamed a.s.

Profeti (a.s.) përmbushte në kohë premtimet e dhëna. Asnjëherë nuk është ndarë nga drejtësia, nuk gënjente kurrë, qoftë edhe në shaka.

Në sajë të kësaj besnikërie ai në mesin e shoqërisë ku jetonte njihej si "Muhamed ul-Emin" ose "Muhamedi Besnik".

Pas namazit të xhumasë u zhvillua një takim pune me imamët e Myftinisë Gjirokastrë.

Myftiu Avni Goma paraqiti një tablo të mbarëvajtjes së punëve në të gjithë xhamitë e myftinisë.

3

TRAJNIM PËR IMAMËT NGA UNIVERSITETI AL-EZ'HER

Me iniciativë të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, u bë e mundur trajnimi i 43 imamëve, predikues e mësues fetarë shqipfolës nga shtete të ndryshme të Ballkanit, pranë Universitetit të mirënjohur al- Ez'her të Egjiptit.

Trajnimi u zhvillua "online", organizimi dhe menaxhimi i të cilit u krye nga Organizata Ndërkombëtare e të Diplomuarve në al- Ez'her.

Ky trajnim u zhvillua nën kujdesjen e veçantë të Shkëlqesisë së Tij, Imamit të Madh të Ez'herit, Prof. Dr. Ahmed al-Tajib.

Imami i Madh Ahmed al-Tajib ruan një konsideratë të veçantë për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Konsideratë e cila ka lidhur fort bashkëpunimin ndër-institucional midis Komunitetit Mysliman dhe Universitetit të Ez'herit.

Trajnimi përmbante një gamë të gjerë tematikash, të trajtuara deri në detajet më të hollësishme nga ekspertë të fushave përkatëse e profesorë të Ez'herit, si: besim, jurisprudencë islame, kulturë predikimi e demaskim/çrrënjosje/nxjerrje në pah të mendimeve e ideologjive ekstremiste që lindin për shkak të keqinterpretimeve nga individë të ndryshëm.

Në prani të përfaqësuesve të lartë të institucionit organizator, kryetari Spahiu falënderoi për zemërsisht shkëlqesinë e tij, Imam al-Tajib për këtë cikël trajnimi në veçanti, dhe për përpjekjet e vazhdueshme të tij dhe të Universitetit të Ez'herit në fushën e përhapjes së mesazhit të saktë e të pa deformuar të fesë islame, duke vënë në pah edhe rolin e pazëvendësueshëm të KMSH në përcimin e këtyre vlerave të fesë islame në rajon e më gjerë.



2

TAKIM ME AMBASADOREN E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË SHQIPËRI

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.Bujar Spahiu, priti në takim Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Yuri Kim.

Kryetari Spahiu i uroi mirëseardhjen ambasadores dhe shprehu vlerësimin për marrëdhëniet e deritanishme ndërmjet institucionit që ai drejton dhe Ambasadës së SHBA në Shqipëri.

Kryetari Spahiu e njohu Ambasadorja Yuri Kim me kontributin konkret që jep Komuniteti Mysliman në mbarëvajtjen e jetës fetare, sigurisë, dialogut dhe paqes sociale në shoqëri, si komuniteti më i madh fetar në vend. Arsimi ishte gjithashtu temë e diskutimit, Kryetari solli në vëmendje shembullin e institucioneve arsimore të Komunitetit Mysliman si medresetë dhe Kolegjin Universitar "BEDER", kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë dhe japin këto institucione në përcëimin e dijes ndër breza.

Ambasadorja Yuri Kim, shprehu vlerësimin maksimal për lidershipin që ka treguar Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në mbajtjen larg të institucionit nga influenza, të cilat bien ndesh me misionin hyjnor të islamit si fe e paqes dhe harmonisë. Ambasadorja garanto mbështetjen e saj personale, dhe të shtetit të cilin përfaqëson, ndaj institucionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjithashtu, Ambasadorja Yuri Kim falënderoi Kryetarin dhe institucionin që ai drejton për bashkëpunimin konkret në luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.





4

NJË PROGRAM KUSHTUAR PROFETIT MUHAMED (A.S)

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvilloi programin fetar me lexim Kurani, ligjërata, dua dhe ilahi kushtuar Profetit Muhamed (a.s), në xhaminë e "Kokonozit".

Programi u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore nga Hafizi Enes Hyka, për të vazhduar më pas me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Tiranës, z. Lauren Luli, i cili pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla në rifreskimin e besimit.

Më tej Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ndau me të pranishmit dhembshurinë dhe mëshirën e Profetit Muhamed (a.s), duke e ilustruar fjalën e tij me shembuj të shumtë nga jeta profetike.

Menjëherë pas tij, fjalën e mori Nënkrjetari, z. Taulant Bica, i cili referoi mbi rëndësinë e të qenurit ummet i Muhamed Mustafas, sipas porositve dhe shembullit të jetës së vetë Profetit (a.s).

Programi vazhdoi më tej me ilahi nga Imami Abdullah Ziba, pjesë nga "Mevludi" të cilat i solli për të pranishmit muezini i kësaj xhamie, z. Osman Kabili, dhe për tu përmbyllur me duanë e përbashkët, të cilën e mbajti imami i xhamisë së Kokonozit, z. Erjol Haxhiu.





5

H. BUJAR SPAHIU MBAJTI HUTBEN NË XHAMINË E PLUMBIT

Më datë 13. 11. 2020, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.Bujar Spahiu mbajti hutben në Xhaminë e Plumbit, Shkodër. Është bërë traditë, tashmë, mbajtja e hutbes në vendin ku u mbajt "hutbeja e lirisë" 30 vite më parë, pas rikthimit të lirisë së besimit në Shqipëri.

Një nga komponentët më të rëndësishëm të lirisë së njeriut, është liria për të besuar, theksoi Kryetari Spahiu në hutben tij përpara besimtarëve të shumtë që morën pjesë në faljen e xhumasë në Xhaminë e Plumbit.

Ai i bëri thirrje rinisë për të rritur shkallën e njohjes së të shkuarës, me qëllim që ajo të mos përsëritet më kurrë.



PËRSIATJE E SHKURTËR MBI LINDJEN E

njeriut modern



Mesjeta dhe Rilindja janë dy epoka të cilat në thelbin e tyre janë krejt të kundërta pavarësisht se zhvillohen në të njëjtin truall gjeografik, Evropën Perëndimore. Që të jemi të qartë dhe të kuptojmë pse këto dy epoka janë në thelb të ndryshme nga njëra tjetra është domosdoshmëri të vëmë në dukje bazamentin ideor mbi të cilin ndërtohet secila prej tyre.

Thelbi ideor i mesjetës ishte botëkuptimi tradicional mbi njeriun, botën, universin. Në bazë të këtij botëkuptimi qëndronte tradita që vjen nga një botë përtej njerëzore, për t'i shenjuar njeriut mënyrën e jetesës në përkohësi. Kështu që në qendër ishte Qenia Hyjnore dhe krejt kuptimet e shpjegimet mbi qenien e vet, botën, universin njeriu i lidhte me fuqinë krijuese e drejtuese të Hyut të Plotfuqishëm.

Thelbi ideor i Rilindjes ishte botëkuptimi modern, i cili lidhet kryekëput me humanizmin dhe Rilindjen. Ura lidhëse e humanizmit dhe Rilindjes është njeriu, tashmë i shkëputur nga lidhja me fenë, besimin e krishterë katolik. Ky njeri nuk e shpjegon më veten, botën, universin në bazë të mësimëve kishtarë si në mesjetë, por përpiket t'i kuptojë dhe shpjegojë këta tri elementë duke u nisur prej vetvetes. Njeriu është në qendër të dhënies kuptimësi jetës dhe botës. Njeriu modern shenjtëron arsyen dhe rrjedhimisht fuqitë shpjeguese të tij, duke marrë rolin e Zotit. Besimi se arsyeja kupton dhe shpjegon çdo gjë, madje dhe vetë Zotin, ishte bazamenti i Humanizmit dhe Rilindjes.

Kalimi nga Mesjeta tek Rilindja pati ndikim në të gjitha sferat e jetës në Evropën Perëndimore. Nga kjo tronditje e thelbit botëkuptimor nuk do të shpëtonte as filozofia. Përgjatë mesjetës filozofia ishte në shërbim të besimit. Filozofët e Mesjetës që njëkohësisht ishin dhe klerikë kishtarë, u përpoqën të gjenin të përbashkëtat e filozofisë antike me besimin fetar, për ta vendosur filozofinë në shërbim të teologjisë. Synohej një bashkërendim i mendimit filozofik të botës klasike me doktrinën kishtarë. Besimi ishte mbizotërues ndaj arsyes dhe arsyeja duhej të përkulej me nderim ndaj besimit.

Në periudhën e Rilindjes filozofia u laicizua.

Përmasa njerëzore tashmë po ndërhynte edhe në realitete ku arsyeja më herët nuk kishte guxuar as të afrohej, veçanërisht në kuptimet dhe interpretimet teologjike. Kjo mënyrë e të vështuarit të qenies njerëzore dhe botës solli ringritje të fuqishme dhe ndikim tepër të madh në mendimin filozofik të modernes, të filozofisë antike. Mesjeta u cilësua epokë e errët, madje u tall e u zhvlerësua nga modernistët që tashmë ishin duke i dhënë më shumë rëndësi formës sesa përmbajtjes. Me njeriun në qendër, me arsyen e ulur në fronin ku më parë qëndronte Hyu i Plotfuqishëm, filozofia moderne i hapi udhë eksperimentalizmit si metodë e studimit të natyrës dhe përfitimit prej saj. Njeriu kishte filluar të besonte se tashmë ishte zot i natyrës dhe i vetvetes. Filozofia moderne po ushqente gjithmonë e më shumë idetë se njeriu duhej të merrte në duart e veta fatin e tij dhe fatet e botës. Teologjia mesjetare ishte thjesht objekt studimi e kritike. Ndikimi i fesë në sferën private dhe publike kishte marrë tatëpjetën. Kjo nuk ishte vetëm meritë e Humanizmit e Rilindjes. Vetë kisha katolike me abuzimet e saj dha një kontribut të madh në ushqyerjen e rrënjës moderne. Kur kjo rrënjë dha frytet e veta, teologjia mesjetare ishte e vonuar në reagimin e saj për ta mbajtur filozofinë të lidhur pas vetes. Shkëputja prej teologjisë mesjetare u perceptua si një domosdoshmëri në nivel absolut për të ndërtuar një shoqëri të re, shoqërinë moderne. Filozofia e laicizuar grishi njeriun të studiojë natyrën, veten, shoqërinë nga perspektiva e njeriut pa Zot, ose me një teologji të dobët thjesht si kurë shpirtërore. Kjo i hapi udhë gjithmonë e më shumë plotësimit të dëshirave njerëzore pa kurrfarë droje nga ndëshkimi hyjnor. Ishte një ndryshim dramatik që e solli njeriun modern në ngritjen e një qytetërimi të ri, qytetërimin modern të Evropës Perëndimore, krejt i ndryshëm nga qytetërimi mesjetar i Evropës Perëndimore.

Me njeriun në fronin e Zotit, moderniteti u kthye në magnet që thith e mban pas vetes energjinë e qenies njerëzore, energji nëpër të cilën njeriu modern nanuritet e sheh ëndrra më sy hapur si padron i planetit që i ka mbetur të pushtojë veç kozmosin.

30 vjet

NGA RIKTHIMI I FESË NË SHQIPËRI

Xhamia e Plumbit

Xhamia e Plumbit, ose xhamia e Mehmet pashë Bushatlliut, i përket vitit 1182 h (1768)

Xhamia me një sallë mjaft të madhe, me një kube të vetme të madhe, është e shtuar me një mihrab (vendfajla e imamit) magjepsës me një kube katërqoshesh ose gjysmërrethi. Në secilën faqe të kasnakut tetëqoshesh ka nga një dritare. Dritaret nuk bien në sy ngaqë janë të mbuluara me një çardak tresh që është vazhdim i vendit të xhemitit të fundit...Xhamia është bërë plotësisht prej guri të gdhendur.

Vendi i xhemitit të fundit dhe pjesa e brendshme e mureve është prej guri shtuf. Shtyllat janë prej mermeri masiv, kurse kokat e tyre, të stilit rokoko...

Xhamia e Plumbit – Monumenti historik më i bukur ndër të gjithë objektet e tjera të lagjes "Tabakë", ndërtesë madhështore e artistike, në stilin arabo-turk që ka tërhequr interesimin e vizitorëve. Kjo xhami i kujton vizituesit begatinë e dikurshme të lagjes "Tabakë" dhe të të tjerave përreth kalasë.

Kjo xhami ka diçka të veçantë nga xhamitë e tjera të Shkodrës. Ndoshta është shpirti i historisë së saj ai që të tërheq e të bën për vete sapo takohesh me të dhe hyn në ambientet mjaft tërheqëse që ka kjo faltore shumëshekullore në vendin tonë. Ndoshta është

shpirti islam i paraardhësve tanë dhe mesazhet e pastra të njësimi të Krijuesit të gjithësisë që gjejmë brenda kësaj xhamie, si një hallkë e qëndrueshme dhe e fortë që lidh realitetin tonë me atë të baballarëve tanë besimtarë. Ndoshta është pozita e saj strategjike në hyrje të qytetit, bri kalasë, pranë Drinit, në një prej lagjeve më të vjetra të qytetit, ku ambienti përreth bie erë historie e zgjon nostalgji kohërash e njerëzish që i dhanë emër këtij qyteti dhe u kthyen në një mozaik vlerash për të...

16 nëntor 1990

"...një grup qytetarësh, shumica të rinj si: Pëllumb Sallku, Bice Myftia, Agron Dibra, Abdullah Myftia, Eljaz Pateriku, Mithat Myftia, Gani Kryeziu, Faik Zaganjori, Mevaïd Tresi, Qamil Nikshiqi, Minir Loku, Ibrahim Bilali, Ferid Lluja, Rasim Sokoli, Halil Veli Dani, Abedin Qallimi, Ferid Hajdari, Rauf Karakaçi e të tjerë morën iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë, për të falur xhumanë, për të ripërtërirë fenë, për të rifituar të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar...

Një rol të rëndësishëm në këtë veprimtari me fjalën e rastit e me drejtimin e besimtarëve për të falur xhumanë, ka luajtur Hafiz Sabri Koçi, i cili u bë simbol i përtëritjes së fesë islame në Shqipëri.

Duke kujtuar këtë ngjarje të shënuar historike, na del përpara ai miting i madh popullor me rreth

60.000 pjesëmarrës nga qyteti e fshati, nga të gjitha moshat...

Kjo ngjarje e paharruar jehoi në çdo familje, ajo u bë nxitje për të ndërmarrë vepra të tjera në dobi të gjallërimit të fesë, për të kapërcyer atë periudhë terri ateist 50 vjeçar."

Hafiz Sabriu ka thënë: "Gëzimi më i madh imi ka qenë më 16 nëntor...sikur linda përsëri. Kur shkova te xhamia, ç'të shihja? Ishte mbushur zi me njerëz. Vargu i tyre zgjatej deri në kala. Altoparlantët rreth e përreth...

Të gjithë filluan të bënin tekbir. Brohoritnin. Masa gjithnjë e më tepër mernte flakë...Kam hipur në një tribunë të ngritur për atë qëllim. Mezi e përmbajta veten dhe s'mundja t'ju besoja syve të mi...S'kisha parë në jetën time aq të tubuar, mbi 55 mijë vetë...E pashë veten aq të lumtur, saqë nuk kisha gajle edhe sikur të bija kurban. Nuk kishte gëzim më të madh për jetën!"

Rahmete dhe respekt për të gjithë ata besimtarë të përkushtuar që kontribuan me pasurinë dhe shpirtin e tyre për skalitjen e datës 16 Nëntor 1990 në kujtesën historike të kombit shqiptar!

Formimi i Bashkësisë Islame të Shqipërisë

Ndërsa mitingu madhështor përfundoi dhe njerëzit tuba-tuba po shpërndaheshin, duke mbartur me vete gëzimin e harenë e asaj dite të madhe, në Xhaminë e Plumbit u organizua shpejt e shpejt një mbledhje për nga përmasat, por me një rëndësi të veçantë historike për të ardhmen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në këtë mbledhje, si të themi në ilegalitet, u vendos krijimi i "Bashkësisë Islame Shqiptare" me qendër në Shkodër.

Nuk u besonim syve tanë

Shkodra, qytet mijërvjeçar, shkëmb i qëndresës dhe vatër e kulturës shqiptare në shekuj. Qyteti i Teutës, Gentit, Barletit, Kara Mahmud Pashës, Shesh Shamisë, Hafiz Ulqinakut, Oso Kukës, Hodo Sokolit e shumë e shumë të tjerëve, po shkel në pranverën e demokracisë.

Shkodra, fortesa më e pathyeshme e dinjitetit, e trashëgimisë, e besimit fetar në Shqipëri, luftoi me të madhe për ta ruajtur dhe për ta mbajtur të gjallë në zemrat e njerëzve dashurinë ndaj të Madhit Zot. Kështu pas një çerek shekulli shtypje, mohim i të drejtave të pamohueshme të njeriut për të jetuar dhe besimin fetar të ndaluar e të shkatërruar padrejtësisht nga ateizmi më

ekstrem komunist, i cili i shfaqti shpifjen më të rëndë ndër shekuj popullit shqiptar duke e quajtur "ateist". Merta për këtë korrigjim fillimisht i takon rinisë shkodrane e cila pa u hamendur e trasoi rrugën në tërë vendin. E riktheu besimin, njerëzoren, fenë. Me këtë rast u vërtetua thënia a ajeti i Kuranit: "Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) dhe Ne do ta ruajmë atë", dhe vërtet, këtu nën trysninë më të madhe e ruajtëm Kuranin në zemrat tona. Tamam në ditën e xhumasë më 16 nëntor 1990, hirësia e tij Hafiz Sabri Koçi bëri inaugurimin, rihapjen e Xhamisë së Plumbit, këtij monumenti të kulturës dhe historisë shqiptare, që sot është e vetmja xhami e mbetur nga 36 xhamitë sa kishte Shkodra. Kjo e dhënë padyshim shpreh lashtësinë dhe kulturën e një qyteti.

Ishte momenti më i gëzuar, kur në tribunë ngjitej Hafiz Sabri Koçi, i cili deklaroi rihapjen e Xhamisë së Plumbit dhe njëkohësisht mundësoi shpërthimin e ndjenjave fetare të shqiptarëve për 25 vjet. Kjo skenë që do t'i kishte befasuar edhe regjisorët më të njohur bëri që të emocionohen edhe mbi 55.000 njerëz të tubuar. Pleqtë bënin dua dhe nuk mund t'i mbanin lotët që edhe një herë e përjetuan këtë ditë që vetëm një muaj më parë iu dukej ëndërr, ishte "mollë e ndaluar" dhe nuk bëhej asnjë tolerim. Në anën tjetër shumë të rinj, fjalëpakë por punëshumë, ishin të vendosur se vetëm në rrugën e Zotit do të jetë e ardhmja e njerëzimit, gjersa fëmijët, brezi më i privilegjuar ndjehej aq fatlum sepse atij do t'i takojë e ardhmja dhe detyra për ta çuar përpara këtë rrugë të filluar nga stërgjyshërit e tyre.

Hafiz Sabri Koçi dukej si djalë i ri plot emocione e përmalluar në vete (duke rikujtuar vuajtjen dhe tmerrin), po gjen ngushëllim kreu vëren masën e tubuar e cila nuk e ka humbur dashurinë për të dhe për fe. Dhe ja me një ton plot energji fillon ta falënderojë Allahun xh.sh. që na e bëri të mundur përsëri të shohim këtë ditë, pastaj nga zemra falënderon rininë shkodrane që me bindje e besim tek i Madhi Zot e solli këtë rast, që bëri jehonë thekshëm në tërë vendin.

Nga kubet e bardha të kësaj Xhamie pas shumë vjetësh u dëgjuan versetet e Kuranit dhe Hadithet e Muhamedit (a.s.) të cilat me besnikërinë më të madhe i kishte ruajtur në memorien e tij Hafiz Sabriu. Përmbajtja e tyre mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi, vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Kjo ditë do të kujtohet ndër breza, si ditë që shënoi një etapë të re, të ndritshme.

MËNYRA E MBAJTJES SË DUARVE NË NAMAZ

Gjatë hyrjes në disa xhami, një person përballet me një grumbull njerëzish të ndryshëm. Ai vëren dikë që qëndron në namaz me duart e kapura së bashku nën kërthizë, disa me duart e tyre të vendosura mbi kraharor, dhe disa me duart e tyre nën kraharor. Ai gjithashtu sheh disa të tjerë që falin namazin me duart e lëshuara anash.

Pas vështimit të një pamjeje të tillë, pyetja që shumë shpesh lind në mendjet e këtyre personave është: "Cila është metoda e saktë e vendosjes së duarve në namaz?" ose "Ku i ka vendosur i Dërguari i Allahut a.s. duart e tij gjatë namazit?"

Diskutimi në vijim do të kërkojë t'i përgjigjet këtyre pyetjeve dhe të përcaktojë Sunetin (metodën më të preferuar) e vendosjes së duarve gjatë qëndrimit (në këmbë) në namaz.

Pika e parë që duhet të sqarohet këtu është se të gjitha mënyrat e vendosjes së duarve në namaz, të përmendura në hadithet profetike, janë të lejuara dhe diferenca e mendimit është se cila prej metodave është më e preferuar prej tyre.

Pika e dytë është se ka shumë pak hadithe autentike (sahih) në lidhje me këtë çështje dhe shumica e transmetimeve, që shpjegojnë

mënyrat e ndryshme të mbajtjes së duarve në namaz, janë klasifikuar ose si shumë të dobët, ose lehtësisht të dobët.

Ky fakt e bën çështjen pak më të ndërlikuar se çështjet e tjera. Megjithatë, shpresohet se deri në fund të këtij kapitulli, suneti dhe metoda më e preferuar e vendosjes së duarve në namaz do të bëhet e qartë.

Hadithet për këtë çështje

Dijetarët pohojnë se nuk ka asnjë hadith të saktë që të vërtetojë mendimin e Imam Malikut për lëshimin e duarve anash trupit gjatë namazit. Disa kanë përmendur se arsyeja për një veprim të tillë është frika e thellë, droja dhe respekti për Allahun e Lartësuar, se kur një person qëndron përpara Tij, ai harron t'i lidhë duart e tij së bashku dhe ato lihen të lëshuara në dy anët e trupit. Cilado qoftë arsyeja, ekzistojnë transmetime nga disa sahabe, të cilët janë falur me duart e lëshuara në dy anët e trupit.

Nga ana tjetër, ekzistojnë transmetime të shumta, që vërtetojnë se Pejgamberi a.s. i vendoste duart në trupin e tij, ndërsa qëndronte në këmbë gjatë namazit.



dhe nuk i lëshonte ato në dy anët e trupit. Këto transmetime, gjithsesi, ndryshojnë shumë rreth faktit se ku i vendoste saktësisht Pejgamberi a.s. duart në trupin e tij. Një transmetim shumë i njohur në lidhje me këtë çështje është ai i Uail ibën Huxhr r.a., i cili gjendet në shumë koleksione hadithesh. Sidoqoftë, dijetarët e kanë etiketuar këtë transmetim si problematik [mudtarib] dhe kontradiktor.

Në një version të këtij transmetimi, që gjendet në Sahihun e Ibn Huzejmes, Ua'il Ibën Huxhr ka thënë: "Kam falur namazin me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe ai vendosi dorën e tij të djathtë mbi të majtën në kraharor". Varianti në Musnedin e El-Bezzarit ka fjalët "afër kraharorit" në vend të "në kraharor", ndërsa te "Musanaf Ibën Ebi Shejbe" theksohet "nën kërthizë".

Dy variantet e para mbështesin mendimin e atyre, të cilët pohojnë se është më e preferueshme vendosja duarve në kraharor ose pranë tij, ndërsa varianti i tretë mbështet mendimin e medhhebit hanefi. Sidoqoftë, duhet vërejtur se të tre këto versione përmbajnë disa elemente dobësie. Secili prej tyre do të analizohet në paragrafët në vijim, së bashku me transmetimet e tjera, për të përcaktuar statusin dhe arsyet e dobësisë së tyre.

Argumente të ofruara nga dijetarët hanefi

1- Ua'il bin Huxhr r.a. tregon: "E kam parë të dërguarin e Allahut a.s. duke vendosur dorën e tij të djathtë mbi të majtën poshtë kërthizës". Ky është version i tretë i transmetimit të Ua'il bin Huxhr, të cilin e përmendëm në fillim të kapitullit, që përmban fjalët "poshtë kërthizës". Disa dijetarë hanefi kanë pohuar se ky version nuk mund të përdoret si provë përfundimtare për opinionin

e mbështetur nga medhhebi hanefi, për arsye se fjalët "poshtë kërthizës" gjenden vetëm në disa botime të Musanaf Ibn Ebi Shejbe dhe jo në të gjitha botimet. Duhet marrë parasysh edhe fakti që, siç e kemi përmendur edhe më parë, ky transmetim ka një tekst të parregullt.

Megjithatë, në "Fet'hul Mulhim" citohet se El-Alame Kasim bin Kutlubega e ka gjykuar këtë version si të saktë. Muhamed Ebu Tajib el-Medenij ka shkruajtur në komentin e tij të Sunenit të Tirmidhiut se ky transmetim ka një zinxhir të fortë, ndërsa Shejh Abid Es-Sindij pohon se: "transmetuesit e tij janë të besueshëm". Gjithashtu, një numër dijetarësh kanë vërtetuar se shtesa "poshtë kërthizës" gjendet në shumë dorëshkrime të Musanaf ibn Ebi Shejbe, ndonëse jo në të gjitha variantet e publikuara së fundmi. Prandaj, pavarësisht nga natyra problematike e transmetimit të Ua'il Ibn Huxhr, ky version nuk mund të konsiderohet plotësisht i papranueshëm, meqenëse ekzistojnë edhe transmetime të tjera të besueshme që e përforcojnë këtë version.

2- Aliu r.a. thotë: "Vendosja e njëres dorë mbi tjetrën poshtë kërthizës është një sunet praktik i namazit". Është një fakt i njohur se sa herë që një sahabi thotë fjalët "është prej sunetit" në lidhje me ndonjë veprim, kjo do të thotë se veprimi në fjalë është marrë nga vetë Profeti a.s. Kështu që, Aliu r.a. mund të jetë shprehur se ky veprim është sunet, vetëm pasi të ketë parë Profetin a.s. duke vepruar në këtë mënyrë.

3- Haxhaxh ibn el-Hasen tregon: Ose e kam dëgjuar nga Ebu Mixhlaz duke e thënë, ose e kam pyetur vetë: "Si duhet dikush t'i pozicionojë duart e tij (gjatë namazit)?" Ai u përgjigj: "Ai duhet të vendosë nën kërthizë pjesën e brendshme të dorës së tij të

djathtë mbi shpinën e dorës së majtë”.

Siç ka përmendur edhe Ibën El-Turkumani el-Mardini, në librin e tij El-Xheuher el-Naki, transmetimi i këtij hadithi është i mirë [hasen].

4- Ibrahim Nek'hai tregon: “Kur dikush është në namaz, duhet të vendosë poshtë kërthizës dorën e tij të djathtë mbi atë të majtën”. Edhe transmetimi i këtij hadithi është, gjithashtu, i mirë [hasen].

5- Ebu Hurejre r.a. transmeton: “Vendosja e njërës dorë mbi tjetrën në namaz duhet të jetë nën kërthizë”.

6- Enesi r.a. transmeton se: “Ekzistojnë tre aspekte nga veçoritë e profetësisë (nubuveh): të çelësh iftarin herët, të shtysh syfyryn dhe të vendosësh dorën e djathtë mbi të majtën nën kërthizë në namaz.”

Argumente të tjera që mbështesin mendimin e hanefive

Dijetarët kanë dhënë argumente të ndryshme se pse duart duhen vendosur poshtë kërthizës dhe përse kjo metodë është klasifikuar si më e preferuara.

1- Edhe pse shumica e haditheve për këtë çështje janë të dobëta në një mënyrë apo një tjetër, transmetimet e paraqitura nga hanefitë janë gjykuar të jenë më të shëndosha se pjesa tjetër.

2- Juristi i madh hanefi Ibn el-Humam pohon: “Në sajë të papajtueshmërive dhe kundërthënieve midis transmetimeve të ndryshme, më e mira është që t'i drejtohem analogjisë dhe arsyetimit. Të qëndruarit përballë Allahut kërkon një qëndrim, i cili shpreh respekt dhe nderim. Meqenëse pozicionimi i duarve poshtë kërthizës është ndoshta mënyra më e respektuar e qëndrimit (në këmbë gjatë namazit), ajo duhet konsideruar si më superiore. Nga ana tjetër, arsyeja përse gratë udhëzohen t'i vendosin duart e tyre në kraharor, është për shkak

se përmes kësaj metode mund të arrihet një përkorje dhe modesti më e madhe”.

3- El-Alame Bedrud-Dijn El-'Ajnij, autori i komentit të mrekullueshëm mbi Sahihun e Buhariut, të quajtur “Umdetul-Karij”, shkruan: “Të vendosësh duart poshtë kërthizës mbart virtut të madh. Është një qëndrim i cili tregon respekt të madh. Ai shfaq një dallim të madh me qëndrimet e jobesimtarëve”.

Ai, gjithashtu, shkruan: “Ky është i njëjti qëndrim që dikush mban përballë sundimtarëve (të kësaj bote)”.

Më pas ai shkruan: “Vendosja e duarve në kraharor krijon një ngjashmëri me gratë, kështu që kjo nuk mund të klasifikohet si një sunet për burrat”.

Përfundim

Hadithet e paraqitura nga shkollat e ndryshme të mendimit përmbajnë disa forma dobësie, ndërsa ato të paraqitura nga hanefitë kanë marrë më pak kritika se të tjerët dhe zotërojnë transmetime më të forta për të mbështetur raportimet e tyre më të dobëta. Kështu që, hadithet e paraqitura si provë për vendosjen e duarve mbi kraharor, ose poshtë tij, nuk mund të merren si tregues i praktikës normale të të Dërguarit të Allahut a.s. Hanefitë, gjithsesi, pranojnë se në disa raste Pejgamberi a.s. i ka vendosur duart e tij në kraharor ose poshtë tij për të shprehur lejueshmërinë e një pozicionimi të tillë [bejanen lil xheuaz]. Vendosja e duarve poshtë kërthizës shfaq një tregues të madh respekti dhe përlulësie. Ashtu siç shumë qëndrime të faljes së namazit për meshkujt ndryshojnë nga ato të femrave, ashtu edhe vendosja e duarve në namaz ndryshon nga mashkulli te femra.

Shkëputur nga libri “Argumente bazë të Fikhut Hanefi”, të autorit Abdurrahman bin Jusuf Mangera, botim i KMSH-së.

Faleminderit Ademit, a.s.

**NGA RRËFIMI I TIJ
KAM MËSUAR...**



Faleminderit Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se disa të sëmurë nuk kanë shkas që të urrejnë. Iblisi e urrejti Ademin, a.s., edhe pse Ademi, a.s., asgjë nuk i kishte bërë.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se nuk duhet besuar çdo gjëje që dëgjon dhe se nuk duhet të më mashtrojë e jashtëmja e çdokujt, ngase shumë ujqër janë të veshur me petkun e misionarit (ligjëruesit) dhe shumë dashakeqës paraqiten si këshilltarë. A thua Iblisi nuk e nxori Ademin, a.s., nga Xheneti duke i thënë:

“O Adem, a do të të tregoj për pemën e pavdekshmërisë dhe sundimit të pazhdukshëm.” (Ta Ha, 120)

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se mëshira e Allahut është më e madhe se mëkati dhe pa marrë parasysh sa është i madh mëkati, nëse

njeriu pendohet sinqerisht pas mëkatit. Ademin, a.s., mëkati e largoi nga Xheneti, por pendimi dhe bindja e sinqertë ndaj Allahut e kthyen pas.

Faleminderit Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam kuptuar se nëse njerëzit dëshirojnë që ta duash vesin e keq, ia ndryshojnë edhe emrin. Kështu ‘pema e mëkatit’ u bë ‘pema e pavdekshmërisë’, kamata bëhet e dobishme, vera quhet pije shpirtërore, ndërsa e shëmtuara bëhet shembull.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se Allahu ka mundur ta krijojë Havën nga dheu sikurse e krijoi Ademin, a.s., por atë e krijoi nga brinja e Ademit, a.s., në mënyrë që ai të ndiejë afinitet ndaj saj, ngase ajo është pjesë e tij.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se nuk duhet urrejtur asnjë krijesë të Zotit, sepse korbi na mësoi se si

duhet varrosur të vdekurit.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se disa njerëz janë të gatshëm të bëjnë çdo gjë për të realizuar qëllimet e tyre; njëri nga bijtë e Ademit, a.s., e vrau vëllain e tij për shkak të gruas.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga rrëfimi i tij kam mësuar se beteja në mes të vërtetës dhe gënjeshtërs është gjithmonë e njëjtë, por ushtarët e së vërtetës dhe ata të gënjeshtërs ndryshojnë.

Faleminderit babait tonë, Ademit, a.s., nga tregimi i tij kam mësuar se jeta pa marrë parasysh gjatësinë e saj e ka kufirin dhe njeriu pa marrë parasysh sa jeton në Tokë në fund përfundon në barkun e saj. Ademi, a.s., jetoi një mijë vjet, e pas kësaj përfundoi në varr.

**Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi**

JETËN TIME TA DEDIKOJ TY JA **RESULALLAH**

Jetën time ta dedikoj ty ja Resulallah

O i dashur profeti Muhamed! Dashakeqët nuk t'u kundërvunë dhe nuk të luftuan vetëm sa ishe gjallë, por edhe pas vdekjes tënde, shekuj më vonë, tentojnë të përbaltin figurën dhe personalitetin tënd, por nuk e dinë të mjerët se një shigjetë drejt teje pasohet nga miliona salavate për ty, që të vijnë nga besimtarë e besimtare nga e mbarë bota. Ti nuk ishe vetëm vulë e profetëve, por edhe u vulose në zemrat e myslimanëve që të besuan dhe udhëzimin që ti solle, me krenari e pasuan. Sa herë që zemërligët hedhin shashka ndaj teje, zgjohet një botë e tërë në mbrojtje dhe mbështetje ndaj teje, sepse ti nuk ishe i dërguar prej Zotit vetëm për kohën kur jetove apo vendin ku qëndrove, por ti je edhe profeti ynë dhe i të gjithë atyre që do të vijnë pas nesh, deri në çastin që do t'i ndëprijet shiriti kësaj bote dhe filmi i saj do të mbarojë.

Nuk do të resht së foluri për ty; së shkruari për ty,

së treguari për ty, së lexuari për ty, së postuari për ty, sepse ti le aq shumë, saqë një jetë nuk mjafton. Nga t'ia nis më parë: nga mëshira dhe butësia që të karakterizonte kurdoherë; nga buzëqeshja dhe thjeshtësia me të cilat paraqiteshe gjithmonë; nga urtësia dhe komunikimi i ëmbël me këdo; virtyte të cilat dëshmuuan bindshëm profetësinë që mbartje mbi shpatulla dhe mesazhin hyjnor që përcolle për mbarë njerëzimin. Kush guxon të të ofendojë, pikë së pari ka ulur dhe nënçmuar veten e tij, sepse jo më kot dhe jo rastësisht ti ishe dhe mbetesh prijësi i të devotshmëve, mëshira e botëve, llambadari që kurrë nuk fikesh, udhëzuesi ynë për në Xhenet.

Ti nuk ke nevojë për të të mbrojtur dikush, sepse ti ke Mbrojtësin më të fortë, Allahun Fuqiplotë, i Cili nëpërmjet veprimeve të pahijshme të disa injorantëve zemërprishur, dëshiron të ta lartësojë edhe më shumë emrin tënd; t'i japë edhe më tepër lavdi famës tënde; t'i nxisë njerëzit për t'u njohur më nga afër me ty dhe



personalitetin tend; ta rizgjojë dhe përforcojë edhe me tepër dashurinë e besimtarëve myslimanë për ty.

Fakti që i tmerron disa individë apo qarqe të caktuara është se si ti, një njeri nga shkretëtira e Arabisë Saudite, arriti të strehohet në gjokset dhe zemrat e miliarda njerëzve; se si një njeri i thjeshtë si ti, arriti të fitojë dashurinë e një numri pa limit besimtarësh, madje pjesa më e madhe e tyre pa të parë dhe pa të takuar fizikisht; se si emri yt lakohet kaq shpesh edhe në ditët e sotme kur kanë kaluar më shumë se 14 shekuj nga prania jote mbi faqen e dheut. Këtë botë e parakaluan burra të shumtë dhe kolosë të mëdhenj, por lavdinë tënde s'e pati asnjëri prej tyre. Ti erdhe i fundit për t'u renditur gjithmonë i pari.

Sa herë shkruaj për ty, fjalët rrjedhin vetë si ruazat e një vargu. Për ty sado që të flitet, prapë se prapë do mbeten ende gjëra pa thënë, sepse t'i i përngjan një pusi, tek i cili, sa më shumë të gërmosh, aq më shumë ujë do nxjerrësh dhe aq më të pastër. Ti i përngjan

një peme të mbushur me fruta plot, drejt së cilës, edhe pse mund të gjuhen shumë gurë, ajo i kthehet çdo gjuajtjeje me fruta të ëmbla, madje ndryshe nga pemët e kësaj bote që prodhojnë në stinë të caktuara, ti je si një pemë që qëndron e mbushur plot në çdo stinë.

Ti je më i shtrenjti për ne, sepse i tillë je dhe për vet Zotin, i Cili nga dashuria e madhe për ty, bashkoi emrin tënd me emrin e Tij, prandaj sa herë që themi "La ilahe Il-laAllah" nuk harrojmë të themi edhe "Muhamedun resulullah". Ty Allahu të bëri pjesë të ezanit; ty Allahu të bëri pjesë të namazit; ty Allahu të bëri pjesë të dhikrit dhe të duave. Ty Allahu, edhe pse nuk të bëri të pavdekshëm fizikisht, emrin tënd e bëri të pavdekshëm përjetësisht. Të ecim në hapat e tu, është nder për ne. Të ndjekim udhëzimin tënd, është privilegj për ne. Të jesh i sigurt profeti ynë i dashur, se nga çdo cep i globit jehon shprehja "Kurban t'u bëfsha ja Resulallah".

NJË KOLEKSION PËR VEPRAT *Islame* NË DANIMARKË

Koleksioni David u themelua nga C. L. David (1878-1960), një avokat i shquar danez, i cili kishte filluar të mbledhte vepra arti në fillim të shek. XX. Duke qenë i pamartuar dhe pa fëmijë, C. L. David la trashëgim shtëpinë e tij në Kopenhagë, pasurinë dhe veprat e artit një fondacioni, i cili bëri të mundur zgjerimin e koleksioneve të tij. Koleksioni i veprave islame është rritur për t'u bërë jo vetëm më i rëndësishmi i muzeut, me mbi 4,000 objekte, por edhe më i rëndësishmi i Skandinavisë në fushën e vet.

Koleksioni Islam është ndërtuar në përputhje me modelin klasik për koleksionet perëndimore të këtij lloji. Ajo mishëron vepra arti nga Spanja (Andaluzia) në perëndim deri në Indi në lindje, nga Afrika Sub-Sahariane deri në Azinë Juglindore. Kronologjikisht, koleksioni varion nga punime që datojnë nga vitet e para të Islamit, deri në mes të shekullit të XX-të. Koleksioni përfshin të gjitha llojet e materialeve, por meqenëse muzeu është një ndërtesë e shekullit të XIX-të me dhoma të vogla, e bëjnë të pamundur ekspozimin e objekteve të mëdha.

Pas rinovimit dhe riinstalimit të koleksionit të tij në 2009, Koleksioni David tani është i ndarë në tre pjesë: Arti Evropian i Shekullit të XVIII-të, Arti Modern i Hershëm Danez dhe Arti Islam. Koleksioni i Artit Islam paraqitet në një mjedis të ri, bashkëkohor, i përmirësuar nga teknikat dixhitale dhe të tjera moderne të përdorura për të sqaruar objektet e ekspozuara. Koleksioni ka 20 seksione kronologjike/gjeografike, si dhe përmban galeri të veçanta për materiale të ndjeshme ndaj dritës, si dhe të tjera kushtuar temave të tilla si historia kulturore dhe teknikat artistike.





Vetmia dhe Uniteti



Zoti e ka krijuar njeriun si njëqenie shoqërore. Individit duhet të dijë se nuk mund të beje qëndresë i vetëm përballë grupeve, bashkimeve dhe bashkësive perverse e destruktive. Një njeri, edhe sikur të jetë në kulm të aftësive të tij, nuk mund të jetojë dot vetëm me gjenialitetin e vet, me botën e vet të dijes dhe kulturës, madje me zbulimet dhe parashikimet e veta i vetëm përballë tufaneve dhe perversiteteve të mëkateve të këtij shekulli, edhe sikur të jetojë, mund të bëhet në çdo kohë pre e ujqërve, sepse është ndare nga tufa! Veçanërisht ai mbetet i privuar nga begatitë që do t'i sjellë, nga avantazhet që do t'i sigurojë dhe favorët që do t'i bëjë të qenit pjesëtar i një bashkësie. Njeriu, këmbët e të cilit nuk shkelin mbi truall bashkësie, është si një gjethe e rënë e cila shkelet me këmbë ose i merr me vete era nga të dojë.

“ Ai që jeton vetëm është një djall”. Po, njeriu që jeton vetëm, herët a vonë mund të bjerë në kurthin e djallit! Çdo mendimi i keq i hedhur nga djalli në mendje dhe përfytyrim, është si një farë që do të mbijë dhe hedhë shtat në dheun e vetmisë dhe shqetësimit shpirtëror. Te njeriu i vetmuar, mendjen, zemrën dhe shpirtin e të cilit e mbushin farat e së keqes dhe mëkatit, është pothuaj e pa mundur që të mos vijë një ditë që këto fara të zhvillohen, të përhapen duke shpërthyer jashtë tij, pra, duke u bërë të dukshme e të japin frytë të mëkatit. Çdo njeri kushedi sa herë e ka ndjerë që e kanë shtypur këto mendime e përfytyrime që e vënë në vështirësi herë pas here, se rrënja e këtyre mendimeve të këqija duhet tharë qysh kur janë ende farë, dhe është perpelitur me pendesë. Vëllezërit dhe shokët tanë të shërbimit ndaj kauzës së përbashkët, janë ndihmësit tanë tejet të dobishëm që mendja, zemra dhe shpirti të mos na pushtohen prej farërave të së keqes që vijnë prej djallit dhe që këto të pastrohen qysh në krye. Njeriu i shkëputur prej shokësh, me mendjen e tij të mbetur të lirë, sidomos “po të hyjë nën jorgan”, zhytet e humbet në botën e përfytyrimit që dëshiron,

ose rend andej nga e zvarrit djalli dhe ndodh që nuk mund të kthehet pa marrë plagë nga ai udhëtim iluziv me pamje rrëqethëse...

Njeriu duhet të ikë nga të mbeturit vetëm, siç ikën nga gjarpri, sepse vetmia i hap rrugë tronditjes së shpirtit të njeriut nga mendimet prej gjarpri. Të njëjtat rreziqe ekzistojnë dhe kur janë dy vetë, sepse është gjithsesi e mundur që të dy vetët të merren vesh për të bërë një të keqe. Kurse, sipas llogaritjeve, është pothuajse e pamundur që tre vetë të merren vesh për të bërë të këqija dhe mëkate. Me formulën “Edhe dy vete janë më afër djallit, kurse tre vetë janë bashkësi që i largohen atij”, vrimat nga mund të hyjë djalli për të zënë vend te njeriu, zvogëlohen shumë!

Shumë herë dhe në shumë vende, zemra dhe fuqia mund të mos na mjaftojnë për të na mbajtur të gjallë e vitalë. Vështrimet mund të na mjegullohen, gjoksin mund të na e mbështjellin mjegulla dhe tymi, zemra mund të na ngurtësohet dhe dashuria me emocionin mund të nisin të humbin mes punëve të përditshme, jetës shumëngjyrëshe dhe, si rezultat i një bllokimi që mund të shkaktohet për pasoje, Zoti na ruajt, mund të biem në mjerim. Po, por të jemi të paktën tre vetë, në mos nga të dy shokët e tjerë, nga njëri, kemi mundësi të ushqehemi me mëshirë, të freskohemi me frymëzime e, kështu, kemi mundësi të vazhdojmë të marrim frymë në një atmosferë pasioni dhe dëshire të lartë.

Strehimi më i rëndësishëm që do e mbrojë njeriun nga egoj, nga rënia viktimë e djallit, nga armiqtë tanë me anë të kanaleve dhe degëve shoqërore në rrugët nga ne do të kalojmë, janë bashkimi dhe uniteti në bashkësi. Ftesa për ta pranuar dhe përvetësuar këtë ide është një nga çështjet më jetësore të ditëve tona.

Në bashkim ka kurdoherë fuqi

Ndërsa dy individë të veçuar nuk e kapërcejnë dot 1-shin, kur vendosen pranë e pranë bëjnë 11, kurse kur vendosen pranë e pranë 3 njësha bëjnë 111. Dhe tani, këtë gjendje që u



përpoqem ta shprehim në mënyrë vulgare me një lojë shifrash, mendojeni duke e krahasuar ndriçimin që do të bëjë një njeri duke mbajtur në dorë një pishtar në errësirë, me ndriçimin që do të bëjnë 11 ose 111 vetë. E njëjta gjë ndodh edhe kur duhet ngritur ndonjë peshë. Shtojini fuqisë së thjeshtë fizikë edhe aleancën e mundësive dhe aftësive mendore e shpirtërore më dijen, njohjen, mendimin dhe arsyen. Veçanërisht në qoftë se në këtë mes ka dhe unitet qëllimi e ideali, si dhe përpjekje e vendosmëri të njëjtë, atëherë zemrat me të vërtetë fillojnë të rrahin me një forcë të tillë që s'kanë ç't'u bejnë as topat! Po kështu, po të mendoni se jeni ndriçuar nën shikimet plot dritë të stolisura me mëshirë, dhembshuri, e buzeqeshje drite të shokeve me nivel shumë të lartë jetësor të botës së brendshme, të botës ndjesore e shpirtërore dhe në fytyrat e të cilëve do të mund të sodisni figura engjëjllore, do ta kuptoni akoma më mirë se në ç'atmosferë kundër mashtimeve të djallit dhe aftësisë djegëse të mëkateve ndodheni! Brenda kësaj atmosfere do të shtohet edhe forca e vullnetit dhe e zemrës tuaj të dobët e cila do të fitojë rezistencë. Si rrjedhojë do të bëheni zotërues të një fuqie të dyanshme.

"Ata janë një bashkësi e tillë që, ai që ndodhet mes tyre, nuk bëhet i pafat!"

Sigurisht ai që ndodhet në trëndafilishtë, të paktën përfiton nga aroma e trëndafilave. Disa herë ndodh që ai i cili largohet nga bashkësia për dy ditë, bëhet sikur të jetë larguar katër ditë, ai që largohet katër ditë, bëhet sikur të jetë larguar tetë ditë dhe e ndjen veten në boshllëk dhe të ndrydhur. Kjo është krejt si puna e errësirës që, sa më shumë të largohesh nga burimi i dritës, bëhet më e thellë.

Njeriu që të fitojë qendrueshmëri ndaj dredhive dhe intrigave të djallit, duhet çdo ditë e më shumë të dimensionohet në mendim dhe

meditim, të mbledhë argumentet e njohjes dhe aftësisë intuitive të Zotit nga libri i gjithësisë si dhe të ndjekë rrugën e shtruar nga profetët. Kështu njeriut do ti përftojë vitalitet shpirti dhe çdo hap i hedhur do të jete për të një burim force. Në të kundërt, biem në ambientim, në pasojën e njerëzve që nuk lexojnë, që nuk mendojnë dhe që nuk e rinojnë vetveten, zbehemi, zverdhemi, na merr era dhe humbemi.

Për të arritur bashkimin, unitetin dhe aleancën, dhe një vëllazëri ku zemrat rrahin sëbashku, në vend të qindra mendjeve, ideve dhe filozofive, duhet të kemi për orientim kriteret e Zotit dhe të Dërguarit të tij! Në vend që të pyesim pse jemi bërë copa-copa, të shmangemi nga fjalët, sjelljet dhe veprimet që çojnë në copëtim dhe, në vend të keshillave për bashkim, të themi fjaë të ëmbla e të bëjmë veprime që çojnë në bashkim.

Njeriu nuk duhet të pretendojë se vetëm rruga e tij është e drejtë dhe, kështu, të mos u njohë të drejtë jete të tjerëve. Besimtari mund të thotë se rruga e tij është e drejtë, e bukur, e mirë, e pëlqyeshme, e goditur, por nuk mund të thotë se vetëm e tija është e drejtë dhe e vërtetë. Është mjaft e natyrshme që njeriut t'i duket më e mirë dhe më e bukur rruga e tij sepse e ka me zemër dhe njeriu bëhet i suksesshëm dhe rezultativ në një punë me aq sa e bën të veten dhe e dashuron atë!

Është gabim t'i nxish të tjerët dhe t'i damkosësh ata si të metë dhe të shemtuar. Duhet të dish si të ulesh e bisedosh me çdo njeri, zemra e të cilit rreh me dashurinë për atdheun dhe popullin, ta miratosh dhe përgëzosh atë pa i dhënë rast hapjes së portës së kritikës dhe t'u përgjigjesh gjërave të bukura me fjalë të bukura.

Kushdo që thotë se vetëm rruga e tij është e drejtë dhe e vërtetë, kurse të tjerat, të shtrembra e të gabuara, pavarësisht se kush është, u hap rrugë pakënaqësive dhe dasive serioze.

Përshtati: Arbi Tarja





HAXHI HAFIZ SABRI KOÇI

(1921-2004)

**KRYETARI I PARË I KOMUNITETIT
MYSLIMAN TË SHQIPËRISË PAS
KOMUNIZMIT (1990-2003)**

Në gjuhën fetare ky lloj njeriu si Hafiz Sabriu quhet Muxhahid, d.m.th. një njeri që shkrin veten për hir të Zotit. Është me të vërtetë një nder që ndodhet në mesin tonë një misionar i tillë, që nuk kurseu as jetën për ruajtjen e shtrirjen e normave morale islame, të luftuara aq egërsisht nga diktatura e shtetit të parë ateist në botë. Ne e falënderojmë për këtë, por shpërblimi i tij do të jetë te Zoti për shërbimin që i ka bërë fesë islame”, do të thonin studiuesit për të.

Haxhi Hafiz Sabri Koçi lindi më 14 maj të vitit 1921 në fshatin Orenjë të Librazhdit. Babai i tij ishte larguar në kurbet, në Selanik për të përballuar jetën e rëndë. Pa u mbushur ende viti i gëzimit të djalit, erdhi lajmi i kobshëm. Idrizi kishte vdekur dhe Sabriu mbeti jetim.

Kështu filloi një jetë plot vuajtje për familjen. Nënë Zenja mposhti dhimbjen dhe u bë për djalin e vogël jo vetëm nënë e dhembshur, por edhe babë, iu përkushtua rritjes dhe edukimit të të birit.

Vdekja e babait e bëri që në fëmijëri të hershme të hyjë shpejt në jetë, të mësojë e të përballojë vetë vështirësitë e t'i zgjidhë ato mbarë e mirë, si e lyp e drejta e zakoni i mirë e mësimet fillestare të fesë Islame që kishte marrë në shtëpinë e vet, e shquar për tradita fetare.

Një zotëri nga Shkodra, Kryetari i Komunës, Adem Kastrati, duke e parë zgjuarsinë e Sabriut të vogël 10 vjeç, ia mbushi mendjen nënës Zenjë dhe kushërinjve, që ta dërgonte në Shkodër për të mësuar. Dhe kështu i vetëm, në vitin 1932, filloi një jetë plot sakrificë e vështirësi, jeta e shkollës dhe jeta e punës. Djaloshi i vogël me sjelljen e tij, me devotshmërinë e tij, me përkushtim e mençuri, fitoi shpejt respektin e të gjithëve, e posaçërisht të mësuesit të besimit, Hafiz Muhamedit, i cili ishte edhe myezin në xhaminë e Rusit të Vogël. Hafiz Muhamedi, duke admiruar zërin e tij aq të bukur e lejonte të kryente ndonjëherë detyrën e myezinit. Pasi mori mësimet fillestare të fesë, Hafiz Muhamed Kastrati, duke parë përparimin e shpejtë të Sabriut në mësimet dhe zellin e përpjekjet e tij, u interesua te myderrizi i shquar, Haxhi Muhamed Bekteshi, që ai ta pranonte si nxënës të vetin (talebe). Kështu, me

ndihmën e pakursyer të Haxhi Muhamed Bekteshit, i cili e trajton si fëmijën e vet, Sabriu i përkushtohet plotësisht studimeve. Për këtë kohë H. Sabriu thotë: “Me sa mbaj mend unë, kah fundi i vitit tridhjetë Shkodra kishte arritur një zhvillim të madh të fesë... Në fakt, ishte ashtu siç i thonë arabët: “Mehdul el ilmi”, djepi i diturisë dhe i kulturës islame”.

Shumicën dërmuese të lëndëve i mësoi te H. Muhamet Bekteshi, ndërsa disa prej tyre, si specialitete të veçanta, si: p.sh. ligjin mbi trashëgiminë dhe Kiraetin (ilustrimin e Kur'anit) e mësoi te Hafiz Sabri Beg Bushati, ndërsa tefsirin e mësoi te Sheh Qazim Hoxha në periudhën që ishte në Shkodër.

Mbas 15 vjet pune këmbëngulëse, më në fund arrin të marrë diplomën (ixhazetin) nga Hafiz Muhamed Bekteshi. E përkthyer në gjuhën shqipe, diploma (ixhazeti) ka këtë përmbajtje:

“Kjo është formula e diplomës sime me të cilën vëllain tim Për Zotin, Zotin në tonë Sabri Idriz Koçi, i cili është i pajisun me të gjitha cilësitë e alta Islame dhe i plotësoi shkëlqyeshëm të gjitha mësimet teologjike të mbështetuna në Kur'anin e Madhnueshëm dhe në Hadithet e Hazreti Muhammedit (a.s.) të mbështetuna edhe në arsyet mendore filozofike dhe unë nevojtar i varfër tek mëshira e të Madhit ZOT, i quajtur Muhamed Mahmud Beqir Shkodrani (Bekteshi).

Data e diplomimit, muaji Rebiul-Evel, ditën e enjte 1370 Hixhri. Muhamet Teufik”.

Një vëmendje e veçantë i kushtojë zotërimit të gjuhës arabe, gramatikës dhe sintaksës së saj, që shërbente si bazë për mësimin e Kur'anit, ilustrimin dhe komentimin e tij. Por, duke marrë parasysh se shtrohej detyra e mësimi të Kur'anit përmendësh, për atë që dëshironte të fitonte titullin “Hafiz”, vështirësitë shtoheshin, aq më tepër duke marrë parasysh kërkesat e larta që kishte Myderrizi i shquar, Haxhi Muhamed Bekteshi.

Pas vitit 1939 emërohet imam në një lagje të vjetër të qytetit të Shkodrës, rrëzë kështjellës “Rozafat”, në Luguçesme, pastaj në Xhaminë e Bardhë e më vonë në lagjen Dudas. Ai me këmbëngulje u

afrua me popullin, u njoh shpejt me burrat e nderuar besimtarë të lagjes, zuri miqësi me ta, për pak kohë ia ndryshoi gjendjen xhamisë, e zbukuroi atë.

Në vitin 1952 emërohet imam në Xhaminë e Rusit të vogël. Hafiz Sabriu plot përkushtim, me përgatitje të lartë fetare, me argumente bindëse, duke rrokur probleme që shqetësonin besimtarët, me fjalën e thjeshtë, por të zjarrtë shtonte radhët e besimtarëve, gjithnjë e më shumë të rinj vinin në xhami e ndiqnin ritet fetare, gjë që binte në kundërshtim të hapur me ideologjinë komuniste, me propagandën e Partisë. Dhe kundërshtimet e goditjet nuk vonuan.

Lidhur me këtë Hafiz Sabriu kujton: "Sekretari i Parë i PPSH-së për rrethin e Shkodrës në atë kohë, me paturpësi vjen e futet në xhami brenda dhe ma nxjerr rininë përjashta, ndërsa kryetari i degës më bën presione nga më të ndryshmet duke më thënë: "Ti je më reaksionari i të gjithë klerikëve, pasi po na e helmon rininë, po ju jep opium, më thotë se duhet të zhvishesha nga petku fetar. Në asnjë mënyrë nuk mund të pranoja diçka të tillë dhe të tërhiqesha nga ajo rrugë që kisha nisur qysh në fëmijëri".

Për ta larguar nga besimtarët e shumtë të Rusit, e transferojnë në xhaminë Plakë, një xhami shumë e njohur, por e vjetër. Nuk ishte lokali ai që i tërhiqte besimtarët. E meremetoj atë, futi ujin brenda dhe e pajisi për bukuri.

Duke parë popullaritetin në rritje të Hafiz Sabriut, organet shtetërore ndërhyjnë dhe e transferojnë në Krujë, gjoja duke e graduar nën/Myfti.

Për ta larguar nga besimtarët, që e ndiqnin kudo, me Dekretin Nr. 534, në bazë të vendimit Nr. 55, datë 23.5.1956 e transferojnë përsëri duke e emëruar Myfti në Kavajë, ku gjeti një mbështetje shumë të ngrohtë nga besimtarët.

Pavarësisht nga vështirësitë e pengesat e shumta, në Kavajë Hafiz Sabriu iu përkushtua detyrës me zell të pasiq. U zmadhua xhamia e Ali Hajdarit, kurse në fshatrat përreth u ngritën 15 xhami të reja. Veprimtaria ishte shumë e madhe në atë periudhë, në të cilën sa vinte e shtohej lufta e pushtetit dhe e organeve të sigurimit kundër fesë.

Ai kërkonte të kthehej në Shkodër, por në vend që t'i plotësohej kjo nevojë jetike për të dhe për familjen, e transferojnë në Korçë.

Me kërkesën e besimtarëve të lagjes Rus i Vogël emërohet përsëri imam në Shkodër. Tashmë përvoja e fituar në shërbim të fesë që në moshë të re, kishte arritur pjekurinë dhe Xhamia e Rusit, siç quhej, u bë objekt diskutimesh të ndryshme në familjet e besimtarëve dhe në zyrat e pushtetit. Populli kërkonte që të kultivohej feja, ashtu siç duhej, ndërsa diktatura gjithnjë e më shumë ashpërsohej. Të gjitha këtyre u erdhi fundi më 4 qershor 1966, kur i vunë hekurat dhe e arrestuan.

Hafiz Sabriu kujton: "Ishte e Xhuma. Pas faljes xhemati po përshëndetej me mua si asnjëherë tjetër. Të gjithë vinin e nuk po largoheshin. Kjo më bëri shumë përshtypje. U përmallova... E me të vërtetë, kjo qe Xhumaja e fundit për mua dhe për besimtarët".

Arrestimi i Hafiz Sabriut ishte një provë e qartë se organet e dhunës nuk lejonin asnjëri, qoftë ky edhe hoxhë apo prift të vepronte i lirë, të shkonte i lirë kundër interesit të politikës së Partisë në fuqi.

Me dënimin e Hafiz Sabriut me akuza të sajara synonin të shuanin besimin në fjalën e Zotit, në mësimet e fesë, synonin t'i hapnin shtegun ideologjisë komuniste, synonin të përgatisnin vitin 1967, vit kur u ndalua me forcë e me dhunë besimi, një nga të drejtat më të vjetra, një nga liritë më të shenjta të njeriut.

Tani e priste burgu, puna e rëndë fizike, tortura e shoqëruar me të gjitha mungesat. Qëndroi në burg 20 vjet, 4 muaj e 18 ditë.

Jeta e Hafiz Sabriut është një provë e gjallë durimi e besimi, vullneti e përpjekjeje për jetë a vdekje. "Ashtu ishte shkruar prej Zotit (xh.sh.), shkruan Hafiz Sabriu, të përjetoja të gjithë atë që njeriu nuk ia dëshiron kurrë njeriut. U mbështeta në Zotin..."

Komunistët, të lidhur me pranga e futën në burg, e ai doli vërtetë i moshuar e i lodhur fizikisht, por me shpirt të lirë, shpirtin e zemrën nuk mundën dot t'ia përulnin, besimin në Zotin nuk mundën dot t'ia shuanin, përkundrazi, vuajtja e

mjerimi qe një provë për të. E ai fitoi e doli më i fuqishëm.

Më 22 tetor 1986 lirohet nga burgu. Një ditë përmallimi. Kishte hyrë 45 vjeç dhe dilte i moshuar, 65 vjeç. Jashtë e priste gruaja e drobitur nga hallet e jetës, djemtë që i kishte lënë fëmijë e ishin bërë burra. Por një gjë kishte rëndësi, kishte fituar mbi të gjitha të këqijat e mjerimet e burgut.

Ishte mëshira dhe fuqia e të madhit Zot, që pas 50 vjetësh të dalë në dritë e drejta, të shpërblehet gjaku dhe sakrificat e qindra e mijëra shqiptarëve, që vdiqën nën breshërinë e plumbave, që u shkrinë në qelitë e errëta apo lanë rininë e pjesën më të madhe të jetës në kampet e shfarosjes e në burgjet komuniste. Po Zoti i ndihmoi. U mposht me turp diktatura.

"16 nëntor 1990". Kjo ditë nuk erdhi rastësisht. Ishin dëshirat dhe ëndrrat e një populli, të ndrydhura e të heshtura, që gufuan aq vrullshëm në ato ditë nëntori. Rinia shkodrane, duke marrë bekimin e prindërve dhe të moshuarve iu përvesh punës.

Atë ditë e gjithë Shkodra ishte në këmbë. Që në orët e para të mëngjesit njerëzit lëviznin nga të gjitha drejtimet: nga ura e Bahçallëkut, nga ura e Bunës, nga Tophana, nga Parruca, nga Perashi, nga Tepja dhe Ajasma po grumbulloheshin në sheshin e xhamisë së Plumbit, në oborret e shtëpive. Lajmi ishte përhapur në çdo familje, në heshtje e vesh më vesh.

Për këtë ngjarje të shënuar për fenë Islame dhe për të gjithë Shqipërinë Hafiz Sabriu ka thënë: Kjo ngjarje më forcoi edhe më tepër besimin në Zotin e vërtetë që thotë në librin e Tij të shenjtë: "Të pafetë duan e përpiqen me të gjitha mënyrat që të shuajnë dritën hyjnore nga zemrat besimtare të njerëzve, por Zoti ka vendosur që ajo dritë të mos shuhet kurrë". (Kur'ani, 9:32).

Ceremonia e 16 nëntorit 1990 nuk qe thjesht një ceremoni fetare, ajo krahas vlerës së saj të ringjalljes së fesë, mori një karakter të hapur politik. Hafiz Sabriu ka thënë: "S'ka krim më të madh se t'i mbyllësh tjetrit derën e shpirtit, derën e ndërgjegjes e të kujtesës së të Madhit Zot".

Në xhaminë e Plumbit u organizua një mbledhje e vogël nga përmasat, por me një rëndësi të veçantë historike për të ardhmen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në këtë mbledhje, si të themi në ilegalitet, u vendos krijimi i "Bashkësisë Islame Shqiptare" me qendër në Shkodër.

Krijimi i Shoqatës "Bashkësia Islame Shqiptare" dhe miratimi i saj më 23.1.1991, zgjedhja e Këshillit të Përkohshëm, e Kryetarit Hafiz Sabri Koçi dhe sekretarit Z. Mithat Myftia, selia e saj në qytetin nismëtar të Shkodrës, qe një ngjarje me rëndësi që nxiti një veprimtari të dendur fetare në të gjithë Shqipërinë.

Më 14 shkurt 1991 u organizua mbledhja e parë zyrtare me përfaqësues nga të gjitha rrethet që u zhvillua në Pallatin e Kulturës "Ali Kelmendi" në Tiranë. Në këtë mbledhje, pasi u diskutua gjendja dhe mundësitë, u shtrua për miratim statuti dhe programi i Bashkësisë Islame të Shqipërisë dhe u zgjodh kryesia e përbërë nga H. Sabri Koçi, Sali Ferhati, Ramazan Rusheku, Sali Tivari, Ismail H. Muçej.

Kryetar i Këshillit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u zgjodh me votim unanim Hirësia e tij H. Sabri Koçi.

Haxhi Hafiz Sabri Koçi kishte besim të thellë në fuqinë e Zotit se feja në Shqipëri do të lulëzojë krahas zhvillimit dhe përparimit të Shqipërisë demokratike. Gjithnjë në fjalën e tij mishërohej qartë dhe në mënyrën më të kthjelltë dëshira dhe përkushtimi ndaj fesë dhe atdheut të tij.

Pas një jete tepër aktive në shërbim të fesë, besimtarëve dhe të atdheut të tij, Shqipërisë, më 18 qershor 2004, Haxhi Hafiz Sabri Koçi u nda nga kjo jetë materiale për të vazhduar udhëtimin e tij të përjetshëm në prezencën e Krijuesit të tij, Allahut të Madhërueshëm.

Ai është vlerësuar nga shumë personalitete vendase dhe të huaja. H. Hafiz Sabriu është dekoruar me titullin "Qytetar Nderi" nga këshillat bashkiak të Tiranës dhe Shkodrës.

Figura e tij e nderuar është bërë tematikë simpoziumesh dhe panelesh në shumë aktivitete të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në qendër dhe rrethe. H. Hafiz Sabri Koçi do të mbetet një figurë e paharruar e Islamit në Shqipëri.

KËSHILLA TË MREKULLUESHME

1. Zgjohu në mëngjes dhe ji i lumtur.
 2. Përkujdesu që buzëqeshja të jetë prezente në fytyrën tënde.
 3. Bëhu i pari që i përshëndet të tjerët me selam.
 4. Thirri njerëzit me emrat e tyre.
 5. Bashkëpunu me çdo njeri, sikurse ai të jetë për ty personaliteti më i rëndësishëm në kozmos.
 6. Përgatit surprizë të papritur për partnerin e jetës sate.
 7. Shtrëngoje atë që e do në kraharorin tënd.
 8. Bëhu shkak që të dikush të buzëqeshë për çdo ditë.
 9. Bëhu gjithmonë dorëdhënës.
 10. Fali të tjerët.
 11. Përdori gjithmonë fjalët 'ju lutem' dhe 'ju faleminderit'.
 12. Bëhu gjithmonë dëgjues i mirë.
- Dhe asnjëherë mos harro:
- Jeto çdo moment të jetës tënde, sikurse ai të jetë i fundit, ngase me të vërtetë ai mund të jetë i fundit.
- Jeto me besim, shpresë e dashuri, gjatë jetës bëhu luftarak dhe dija vlerën jetës.



Kur të dali shpirti prej trupit të mjerë,
ah unë po ndahem do të thotë nje herë!
Në dyshek lëshuar sheh veten e tija,
sheh si janë mbledhur aty dhe miqësia.

Tri herë do t'thëra si i vdekuri i mjerë,
por ne s'e degjojmë atë zë të prerë!
Lutet edhe thotë për Zotin e vërtetë,
ujët që t'më lani të mos jetë i nxehtë!

Se unë e kam trupin tashti të munduar,
nga jeta në vdekje porsa kam kaluar!
Sikur ta dëgjonte zërin njerzia,
shpirt nuk do mbetej, vdesin gjithësia!

Shpirtin në amshim sikur ta vështrojmë,
një Melek i vjen do ta kuvendojë!
Trupin tënd të vdekur a e sheh i thotë,
vallë si jetove ti në atë botë?!

Detyrat që duhen vallë a i punove,
apo me gjynahe jetën ti e çove?
Në tabut e vëmë në varr tu' e çuar,
mbi tabut vjen shpirti, ndrydhur, frikësuar!

Ah, i mjeri unë, m'u shembë gjithësia,
më mbaroi dynjaja, m'filloi llogaria!
Ja falim namazin për të fundit herë,
në varr e mbulojmë, sot e përngaherë!

Ah, njerinë e mjerë me dhe mbulojmë,
sikur ta shikonim ku dhe ne do t'shkojmë!
Vëllezer të vërtetë, të gjithë ju po shkoni,
të gjithë ju po ikni, mua mos më harroni!

Ku është dashuria më para që kishim,
ku janë edhe fjalët e ëmbla që flisnim?
Babai im ku është sa fort që më donte,
ku është edhe nëna pa mua nuk duronte?

Në shtëpi t'mos isha në derë do të dilnin,
një natë unë t'mos isha, ata gjumë nuk kishin!
Në shtëpin varrit ah, ç'më kanë lëshuar,
trupin e kam zhveshur, me qefin mbuluar! Shiko më pak

POEZI E SHKRUAR

NGA HAFIZ ABDULLAH

ZËMBLAKU (1892-1960)



KONCEPTI I FAMILJES NË

Islam

Familja është një institucion hyjnor i frymëzuar nga Zoti. Institucioni i familjes luan rol të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo është njësia themelore në atë shoqëri dhe është e organizuar në atë mënyrë që të veprojë si bashkësi në miniaturë. Origjina e institucionit të familjes përkon me krijimin e njeriut. Lidhur me këtë në Kur'an thuhet: "O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra"

Familjes, ajo është njësia bazë e çdo shoqërie nën hijen e së cilës formohet dhe mishërohet e ardhmja. Është pikërisht familja ajo që i jep fëmijës mësimet e para të jetës, është vendi ku fëmija ushqehet me moralin, vetitë dhe virtytet e larta. Duke pasur parasysh se baza për formimin e një familjeje është burri dhe gruaja, Krijuesi për ta caktoi kufi, detyra e rregulla dhe bëri me dije se të vepruarit sipas atyre rregullave çon në formimin e një familjeje të shëndoshë e të lumtur.

Martesa dhe krijimi i familjeve ka qenë dukuri e hasur jo vetëm tek njerëzit e thjeshtë por, edhe tek profetët. Kjo tregohet në këtë ajet ku thuhet: "Ne kemi dërguar peygamberë edhe para teje, o Muhammed. Ne u kemi caktuar atyre bashkëshorte dhe fëmijë (trashëgimtarë)."

Termi familje përdoret për të emërtuar një lloj të veçantë të strukturës, parimet e së cilës janë të

lidhur me njëri-tjetrin përmes lidhjeve të gjakut dhe marrëdhënieve bashkëshortore, dhe lidhshmëria e të cilëve është e një natyre të atillë, sa të kërkojë "kërkesa të ndërsjella", që janë të përcaktuara nga feja, të përforcuara nga ligji dhe të sendërtuara nga individi.

Familja (familia, nga famulus – rob shtëpie, shërbëtor) është njësia shoqërore më e vogël e përbërë nga dy ose më shumë persona të cilët kanë midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi; që jetojnë në të njëjtin mjedis për një kohë relativisht të gjatë, kanë marrëdhënie kulturore dhe ekonomike të përbashkëta si dhe përkujdesen për njëri-tjetrin.



Familja është institucioni themelor i përgatitjes së fëmijëve, i transmetimit të vlerave kulturore e morale, i traditave dhe zakoneve familjare, shoqërore dhe kombëtare.

Familja ka pasur gjithmonë një vend të rëndësishëm në historinë njerëzore. Padyshim, baza e njerëzimit është familja dhe tiparet themelore të njeriut fillojnë të formohen në familje. Familja është shtylla më e rëndësishme e shoqërisë. Zhvillimi dhe mirëqenia e një shoqërie varet nga rëndësia që i jepet familjes. Nuk mund të flitet për shoqëri të shëndoshë, nëse ballafaqohemi me problemin e familjes së shpërbërë dhe të pa konsoliduar.

Familja është bazë e gjithë strukturës socialkulturore dhe është një mekanizëm më se i mjaftueshëm për të siguruar stabilitetin social, ideologjik e kulturor të shoqërisë dhe shëmbëllimin e saj në të ardhmen. Islami familjen e trajton si çështje shoqërore nga e cila varet edhe e ardhmja e shoqërisë. Në këndvështrimin islam, familja ka rol biologjik dhe kulturor. Roli biologjik është i lidhur me vazhdimësinë e llojit njerëzor ndërsa roli kulturor shihet në pozitën që ajo ka në transmetimin e vlerave kulturore ndërmjet brezave. Pra, familja në një kuptim më të gjerë të saj është në themel të ekzistencës.

NUK ËSHTË NGA NE AI QË MASHTRON!

Rrëfëhet për një njeri të ndershëm se i porosiste punëtorët e vet që njerëzve tua paraqesin të metat e mallit nëse gjendeshin në të! Dhe një ditë nga ditët, erdhi një çifut në dyqan dhe bleu një palë tesha që në to kishte mangësi, kurse pronari i dyqanit nuk ishte prezent. Shitësi tha në vetvete: ky është çifut dhe s'është me rëndës t'i tregojmë se teshat janë me të meta!

Më vonë erdhi pronari dhe e pyeti për teshat, kurse punëtori iu përgjigj: la shita një çifutit për tre mijë derhem dhe nuk ia tregova të metat!

Pronari i tha: Ku është ai?!

Iu përgjigj: Është kthyer së bashku me karvanin!

Pronari i mori të hollat me vete dhe shkoi pas karvanit, derisa e takoi pas tre ditëve rrugë! Çifutit i tha: O ti filan, ti ke blerë tek unë një palë tesha dhe në to ka të meta! Merri të hollat e tua dhe sillmi teshat.

Çifuti i tha: Çfarë të nxiti të veprosh kështu?! Pronari i tha: Islami! I Dërguari i Allahut, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, na ka mësuar se: "Nuk është nga ne ai që mashtron".

Çifuti tha: Dërhëmët me të cilat i pagova teshat ishin false! Merri këto tre mijë derhem të vërteta, dhe të shtoj edhe më tepër se ato: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij.

KUSH ËSHTË I PASUR E KUSH FUKARA?!

Një ditë nga ditët, një pasanik e mori të birin e vet dhe udhëtuan në drejtim të një shteti të varfër, me qëllim që i biri të shikojë se si jetojnë fukarenjtë. Atje ata kaluan disa ditë e net në një fermë së bashku me një familje të varfër. Gjatë kthimit nga udhëtimi, e pyeti prindi të birin:

Si ishte udhëtimi? – I biri iu përgjigj: Udhëtimi ishte i mrekullueshëm. – A e vërejte se si jetojnë fukarenjtë, o biri im?! – Po, iu përgjigj i biri.

Atëherë biri im, më trego se çfarë mësove nga ky udhëtim?! – I biri tha:

Pashë se ne e posedojmë një qen, kurse ata i posedonin katër.

Ne kemi liqen në mesin e kopshtit tonë, kurse ata kishin përrua i cili nuk ka fund.

Ne kemi vendosur fenerë ta ndriçojnë kopshtin tonë, kurse ata kishin yje në qiell që u bëjnë dritë.

Muri i shtëpisë sonë përfundon tek kopshti, kurse ata nuk kishin aspak mur, i rrethonte horizonti.

Ne posedojmë hapësirë të vogël në të cilën

jetojmë, kurse ata posedonin hapësira që i tejkalonin ato fusha.

Ne kemi shërbëtorë të cilët na shërbejnë, kurse ata i shërbenin njëri-tjetrit.


Ne e blejmë ushqimin, kurse ata hanin nga ajo që mbillnin vetë.

Ne posedojmë mure të larta që të na mbrojnë, kurse ata kishin shokë që i mbrojnë.

– Prindi i djaloshit mbeti pa fjalkë nga këto që dëgjoji nga i biri i tij...në fund, i biri i tha: O babai im, të falënderoj që ma mundësove të shoh se sa fukarenj jemi.

A nuk e sheh këtë tregim si shembull të mrekullueshëm për të medituar?! Të vetëdijeson ta falënderosh Allahun e Madhëruar për të gjitha ato begati që ti ka dhuruar... në vend se të pikëllosh dhe të mendosh për ato që nuk i posedon!

Ty të mbetet t'ua dish vlerën gjërave që i posedon, dhe në fund ta vërtetosh se kush është i pasur e kush i varfër!



“MOS BËNI ÇRREGULLIME NË TOKË PAS RREGULLIMIT TË SAJ (ME ARDHJEN E PEJGAMBERËVE) DHE LUTENI ATË DUKE PASUR FRIKË (DËNIMIN) DHE DUKE SHPRESUAR (MËSHIRËN). S’KA DYSHIM SE MËSHIRA E ALLAHUT ËSHTË PRANË ATYRE TË MIRËVE.”

(ARAF, 56)



BOTIMET KMSH

MUND TA GJENI PRANË LIBRARISË “MIQTË E LIBRIT”



KALENDERARI 2021
(1442-1443 HIXHRI)